



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3083/2 prot

Datë 13.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK**  
**ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË**  
**TJERË**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë

Skualifikimin e operatorit ekonomik “Xheksoni-04” SHPK nga procedura e mësipërme të prokurimit.

Skualifikimin e operatorit ekonomik Gjergj Buça p.f nga procedura e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK me NIPT L42004007D dhe adresë: Tranë, Kamëz, Bathore, Rruga “Ismail Qemali” pike tregtimi lëndësh drusore me nr. Pasurie 192/49, zona Kadastrale 2066, afër Kuvendi i Junikut

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Mirditë me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen

**Subjekte të Interesuar:**

Operatori ekonomik “Xheksoni-04” SHPK me NIPT K39010090G dhe adresë: Rrëshen, SHESHAJ, Lagjja "Nokaj", banesë private 2-katëshe nr.4, kati parë

Operatori ekonomik Gjergj Buça p.f me NIPT  
K31331547R dhe adresë: Durres, DURRES, Ura Dajlanit

Në datën 12.12.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Bora-2K” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3681, datë 12.12.2023, dhe me nr. 3083/2023 prot., datë 12.12.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87566-11-14-2023 me objekt “Blerje dru zjarri, Bashkia Mirditë”, me fond limit 2,787,720.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Bora-2K” SHPK, si dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Xheksoni-04” SHPK dhe Gjergj Buça p.f pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma ‘b’ dhe ‘c’ të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”. Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Bora-2K” SHPK kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3681, datë 12.12.2023, dhe me nr. 3083/2023 prot., datë 12.12.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*Operatori ekonomik (OE) nuk ploteson furnizimet e ngjashme sipas percaktimeve të kerkuara ne Dokumentat e Tenderit DT. Sherbimet e paraqitura per bashkine Kamez mungon kontrata e plote e saj ndersa per bashkine Librazhd mungon vertetimi i realizimit dhe kontrata. Nuk ka deklaruar mjetin qe kerkohet ne DT konkretisht ne formularin permbledhes rubrika elemntet konkret. Nuk ka plotesuar origjinen e mallit. Per kete OE ka paraqitur dokumenta fotokopje te cilat nuk merren per baze. Mungon leja e shfrytezimit te Sinanit qe ka paraqitur fatura blerje prej saj. Nuk plotesohet pika se subjekti eshte kontrolluar nga Inspektoriati Shteteror i Mjedisit dhe Territorit dhe se nga kontrolli, subjekti ka rezultuar konform legjislacionit ne fuqi.*

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimes “Bora-2K” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët e tjerë ekonomikë “Xheksoni-04” SHPK dhe Gjergj Buça p.f pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për operatorin ekonomik “Xheksoni-04” SHPK ngrihen pretendime se nuk përmbush kriteret si më poshtë:

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që verteton origjinën e mallit:** (OE duhet të plotësojë minimalisht njerin nga kushtet e mëposhtme)

- a. *Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me dru nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe fakturën tatimore të shitjes. ose kontratë furnizimi me këta të fundit shoqëruar me dokumentacionin e mesipër (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe fakturë tatimore shitjet Bashki/Koncesionar) si dhe fakturën tatimore të blerjes. (sipas vkm 438 datë 08.06.2016).*
- b. *Nëse ofertuesit janë importues të druve të zjarrit nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore. Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontratë furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me fakturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës*

**2.3.4. Ofertuesit duhet të paraqesin dokumentacion të rregullt që subjekti i tyre është kontrolluar nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Territorit dhe se nga kontrolli, subjekti ka rezultuar konform legjislacionit në fuqi.**

Gjithashtu operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK pretendon se vetedeklarimi i dorëzuar prej këtij operatori shtojca 8 nuk është plotësuar sipas shtojcës së miratuar në DT e reja të APP-së si dhe nuk është plotësuar sic kërkohet seksioni për deklarinimin e mjeteve.

Për operatorin ekonomik Gjergj Buça p.f ngrihen pretendime se nuk përmbush kriteret si më poshtë:

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që verteton origjinën e mallit:** (OE duhet të plotësojë minimalisht njerin nga kushtet e mëposhtme)

a. *Ofertuesit duhet te paraqesin kontraten e furnizimit me dru nga subjekti shites Bashki/Koncesionar shoqeruar me lejen e shfrytezimit te pyllit dhe faturen tatimore te shitjes. ose kontrate furnizimi me keta te fundit shoqeruar me dokumentacionin e mesiperm (kontrate furnizimi, leje shfrytezimi dhe fature tatimore shitjet Bashki/Koncesionar) si dhe faturen tatimore te blerjes. (sipas vkm 438 date 08.06.2016).*

b. *Nese ofertuesit jane importues te druve te zjarrit nga jashtë duhet te paraqesin deklaratën doganore.Nese nuk jane importues do te paraqesin kontrate furnizimi me importuesit shoqeruar dhe me faturen tatimore te blerjes, kjo në mënyrë qe Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyre të garantohet realizimi me sukses i kontratës*

**2.3.4.** *Ofertuesit duhet te paraqesin dokumentacion te rregullt qe subjekti i tyre eshte kontrolluar nga Inspektoriati Shteteror i Mjedisit dhe Territorit dhe se nga kontrolli, subjekti ka rezultuar konform legjislacionit ne fuqi.*

Gjithashtu operatori ekonomik “Bora-2K” SHPK pretendon se ky operator nuk ka plotësuar seksionin për deklarimin e mjeteve në Vetëdeklarimin sipas shtojcës 8.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 13.12.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**